

Prot. 2211/228 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: *Partia Lëvizja për Ndryshim*

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin LN, KRIIK ka konstatuar se:*

- *partia ka deklaruar pranimin e 4 dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*

- *3 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*

- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Lidhur me pranime të dhurimeve mbi 50.000 lekë jo nëpërmjet llogarisë bankare

Partia Lëvizja për Ndryshim ka deklaruar 4 dhurues me shuma përkatësisht nga 75.000 lekë secili të kryera me para në dorë.

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të LN për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Kandidatja e LN, znj. Jozefina Topalli për faqen në *Facebook* të së cilës është paguar shuma 157.043 lekë, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

Kandidati i LN, z. Lekë Negri për faqen në *Facebook* të së cilit është paguar shuma 14.352 lekë, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

Kandidati i LN z. Gjon Ndoj, për faqen në *Facebook* të të cilit është paguar 2 herë me shuma të cilat janë të pamundura për t'u indentifikuar saktësisht për shkak se në secilin nga rastet janë më të vogla se 100\$, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se LN nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim**

dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania